

ASPEKTET SOCIO-PSIKOLOGJIKE MES GJUHËS DHE KULTURËS NË KONTEKSTIN E MËSIMDHËNIES SË GJUHËS GJERMANE NË SHQIPËRI

Dr. ERGYS PRIFTI

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

ergys.prifti@unitir.edu.al

Msc. ELFRIDA BILAJ

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Universiteti i Tiranës

ABSTRACT

This presentation intends to show to German learners, future German teachers etc. some fundamental didactic problems which we consider to be important fields of action in teaching and learning the German language. Here we cover some problems from different linguistic areas such as phonetics, spelling, grammar, lexicology, etc. Practical solutions are also suggested for several problems.

Keywords: Pedagogy, German language, Albanian language, learning, preparation, psychology, grammar, articulation, understanding, spelling, emphasis, scientific truth

Kjo kumtesë është një përpjekje për të shtruar disa probleme themelore didaktike për nxënësit dhe studentët, mësuesit e nesërm të gjuhës gjermane, probleme të cilat mendojmë se përbëjnë fusha të rëndësishme të veprimtarisë në mësimdhënien e nxënien e gjuhës gjermane.

Mësimdhënia e gjuhëve të huaja, si pjesë e të mësuarit, është objekt i drejtpërdrejtë i didaktikës në përgjithësi dhe i metodikës në veçanti, duke shkuar drejt orientimit të procedurave didaktike në procesin mësimor.

Parimet themelore didaktike, si orientime shumë të rëndësishme për t'u zbatuar, kanë fushë të plotë veprimi për mësuesit dhe pedagogët, që punojnë në të gjithë kategoritë e institucioneve arsimore me nxënës të moshave të ndryshme por edhe me studentë, të cilët janë përqëndruar në mësimin e gjuhës gjermane.

Shtrirja e sotme e të mësuarit të gjuhës gjermane premtan për një zgjerim të shpejtë e të mëtejshëm të saj në mbarë hapësirat shqiptare, drejt dy- dhe trefishimit të institucioneve e kontingjenteve që e ndjekin.

Vendi që zë gjuha gjermane në planin mësimor të gjimnazëve me orientim gjuhësor, është shumë i rëndësishëm për faktin se çdo ditë zhvillohen rreth një orë mësimi në këtë gjuhë. Por edhe në shkollat të tjera, ku është shtrirë të mësuarit e saj, ajo është vlerësuar si lëndë.

Mësimi i gjuhës gjermane në këto gjimnaze vjen pas një përgatitjeje teorike e praktike në gjuhën amtare të kryer në shkollën 9-vjeçare, por kryesisht fillestar në njohuritë e gjuhës gjermane.

Edhe formimi letrar është i ndryshëm sa i përket njohjes së letërsisë gjermane, një domosdoshmëri për formimin e përgjithshëm të nxënësve e studentëve, që mësojnë këtë gjuhë.

Pra, problemi i vijimësisë në të mësuar nuk qëndron, por disi më i zbutur është në fakultet në kontingjentin e atyre studentëve, që kanë njohuritë e nevojshme në gjuhën gjermane.

Kuptohet se diferencat cilësore, sidomos vitin e parë, edhe në fakultete qëndrojnë, por shkojnë drejt zbutjes e shkrirjes në vitet e dyta dhe të treta.

Vetë mësimi i gjuhës së huaj ndikon edhe në njohjen e gjuhës amtare, siç ka ndikuar më parë kjo në njohjen e gramatikës e të gjuhës së huaj në përgjithësi, jo vetëm nga fakti se gjuha është e fondit indoeuropian por edhe për faktorë të tjerë.

Pra edhe gjuha e huaj ndikon për mirë dhe e bën më të lehtë, më elastike e shprehëse edhe gjuhën amtare.

Përpara se të grupojmë drejtimet themelore didaktike dhe synimet tona në këtë fushë, po përmendim disa vështirësi, mangësi dhe dobësi

në njohuritë e nxënësve dhe studentëve që mësojnë gjermanisht, të cilat i kemi konstatuar edhe në anketimet e zhvilluara me nxënës dhe studentë.

Disa prej këtyre problemeve janë më afatgjata:

1. fjalor i kufizuar në gjuhën gjermane. Kuptohet që është e vështirë të realizohet procesi i të folurit, që është aspekti më i vështirë, i ligjërimit dhe ku kombinohen dijet gjuhësore me aftësitë për t'i përdorur sipas situatave konkrete, pa pasur një fjalor të pasur;

2. theksimi dhe artikulimi i drejtë dhe i saktë i fjalëve dhe fjalive në gjuhën gjermane

3. vështirësi në aplikimin e rregullave të reja drejtshkimore, (të cilat janë vendosur në vitin 1994) , por akoma jo të qarta për disa nxënës dhe student;

4. në ndërtimin e fjalive ka vështirësi në renditjen e gjymtyrëve të fjalisë, sidomos në fjalitë e nënrenditura me kallëzues të përbërë;

5. përdorimi i foljeve të parregullta dhe formimi i kohëve gramatikore të tyre;

6. përdorimi i parafjalëve të duhura dhe rasa, e cila i shoqëron ato;

7. aplikim më i gjerë i ushtrimeve fonetike;

8. zhveshja nga emocionet në gjuhën e folur, e cila mund të kapërcehet me më tepër bashkëbisedim në gjermanisht me nxënësit gjatë orës së mësimi, sidomos në vitet e para të shkollës së mesme apo të fakultetit;

9. mjedisi gjuhësor i varfër ndikon gjithashtu negativisht dhe i rrit vështirësitë në punën për të mësuarit e gjuhës gjermane;

10. përgatitja psikologjike e nxënësve, veçanërisht në vitet e para, për t'u ambjentuar me tingëllimin dhe theksin në gjuhën gjermane, veçanërisht në dhjetë ditët ose dy javët e para të mësimi të gjuhës;

11. pasurimi i brendisë së të mësuarit, jo vetëm me tekste standarte e vetëm me gjuhën e tekstit, por edhe të komunikuarit me tekste me përmbajtje shoqërore e zyrtare, p.sh. tipe letrash shoqërore, aktesh zyrtare, korrespondencë etj;

E rëndësishme është që njohuritë që jepen për gjuhën gjermane, të kenë vërtetësi shkencore. Kjo është një nga kërkesat didaktike

themelore, madje kryesorja për mësimdhënien dhe të mësuarit e gjuhës së huaj.

Ky parim do të thotë, që mësimi të zhvillohet me nivel shkencor, pa gabime, informacioni që jepet të jetë i vërtetuar për vërtetësinë e tij, gjuha që përdoret në mësim të jetë konform kërkesave të gjuhës letrare, e jo një e folme dialektore apo krahinore, duke pasqyruar, kështu, gjuhën bashkëkohore.

Duhet të përdoren materiale të botuara në vitet e fundit.

Tendenca për t'i dhënë shumë informacion nxënësit, e cila vërehet tek disa mësues, krijon mbingarkesë, atakon dhe nuk është në përputhje me parimin didaktik të marrjes në konsideratë të gradualitetit.

Në zhvillimin e njohurive që janë përcaktuar në program, vihen re në disa raste përpjekje për t'i dhënë nxënësit pjesën më të madhe të njohurive, nuanca të holla gramatikore, kërkohet një shqiptim i përsosur si dhe një njohje e një pjese të mirë të fjalorit.

Këto vështirësi që paraqiten në të mësuarin e gjuhës së huaj duhet të trajtohen me kujdes e me durim nga mësuesit dhe pedagogët. Ato as nuk duhen fetishizuar, as nuk duhen lënë pas dore. Nocionet gramatikore nuk rekomandohet të punohen menjëherë, por pas punimit të tekstit, duke bërë kujdes që ora e mësimit most ë zihet vetëm me rregulla gramatikore. Sigurisht që merren në konsideratë edhe rastet e shumta të përjashtimeve, të cilat gjithashtu përbëjnë “rregulla më vete”. Edhe këto njohuri zhvillohen në mënyrë graduale.

Në këtë kuadër është i rëndësishëm përvetësimi i bazave të gjuhës, që ka të bëjë me elementet fillestare gjuhësore.

- Në fazën e parë të të mësuarit të gjuhës gjermane është e nevojshme të jepen më pak njohuri gramatikore, të cilat mund të zhvillohen disi më vonë, mbi bazën e gradualitetit të dhënies së njohurive dhe të vazhdimësisë së tyre.

Dhënia e njohurive sipas një sistemi dhe vijimësie logjike është bazë për të rritur rendimentin e kohës mësimore në dispozicin. Ky është një problem jo vetëm për grupet e kurrikulës, për ato që hartojnë programet dhe tekstet mësimore, por është po kaq i mprehtë edhe për mësuesit dhe pedagogët në tërë etapat e orës së mësimit në gjuhën

gjermane. Që në bisedat e para duhet bërë kujdes që njohuritë të jenë një rrjedhë logjike në vazhdimësi.

Kjo është e lidhur edhe me të nxënëit nga ana e nxënësve dhe studentëve, zhvillimi tek ata i aftësive të tyre për të punuar sistematikisht e në mënyrë të pavarur.

Pra, kur themi që të përpiqemi për përvetësimin e bazave të gjuhës, ne kemi parasysh përvetësimin e asaj që është më e domosdoshme dhe që qëndron në themel të gjuhës.

- Një problem madhor në fushën e didaktikës për gjuhën gjermane është dhe **lidhja e teorisë me praktikën**, aftësimi praktik i të folurit e të shkruarit të nxënësve. Kjo lidhet me aplikimin e ushtrimeve gjuhësore, me analiza teksti, të filmave të ndryshëm, me bashkëbisedime të lira, të cilat qartësojnë problemet e lëndës, të ushtruarit e nxënësve dhe të studentëve në të kuptuarit e gjuhës së shkruar e asaj të folur në procesin e ligjërimit.

Në këtë kuadër trajtohen edhe probleme të përgjithshme që synojnë në aftësimin e nxënësve dhe të studentëve në ushtrimin praktik të gjuhës.

- Kështu, duke parë ose interpretuar filma e tekste të ndryshëm, lehtësohet puna me fjalorin, krijohen situata që kërkojnë diskutim të lirë, të cilat nxitin imagjinatën e nxënësve dhe të studentëve, duke gjallëruar aktivizimin e tyre.
- Bashkëbisedimi në këto raste është interesant. Si në të gjitha fushat e gjuhësisë, të gjuhës amtare ose të gjuhëve të huaja, duke individualizuar gjuhën gjermane, ka vlera të mëdha uniteti mes tyre (gjermanisht-shqip), duke e kuptuar si domosdoshmëri të pashmangshme kalimin në njëanshmëri.
- Për lidhjen e teorisë me praktikën luan një rol të veçantë laboratorit i gjuhës së huaj, sidomos kur pasurohet me fond të pasur ushtrimesh fonetike, të cilat përmbledhim vështirësitë tipike që u dalin nxënësve e studentëve në shqiptimin e gjuhës gjermane.
- Gjuha gjermane ushtrohet nga mësuesit dhe nxënësit, duke zbatuar edhe parimin didaktik të ekonomizimit në gjithçka.

Kjo do të thotë:

- kursimi në kohën materiale, duke e ruajtur e shfrytëzuar atë me efikasitet të lartë;
- shfrytëzimi me efikasitet i çdo etape në orën e mësimit, duke kursyer kohën materiale në hapat metodike, duke krijuar situata të qarta e të kapshme nga nxënësit, në mënyrë që të mos humbet kohë për të kuptuar situata të paqarta në orën e mësimit;
- evitimi në maksimum i ushtrimeve të mërzitshme, të cilat nuk aktivizojnë klasën, masën e nxënësve.

Në zbatim të këtij parimi themelor të didaktikës është me vlerë edhe ekonomizimi i literaturës së përdorur, zgjedhja cilësore e së cilës çon direkt në konceptet bazë, që të jep shkurt e qartë përgjigjen e kërkuar, ose të çon në rrugët e dhënies së përgjigjeve.

Gjuha gjermane hyn në fondin e “gjuhëve moderne”, si trajtohen aktualisht në literaturën botërore.

Të ndjekësh mësimet në këtë gjuhë, në kushtet aktuale për shqiptarët, nuk teprohet po të thuhet se është një privilegj.

Në të gjitha institucionet arsimore me mësimdhënie të gjuhës gjermane është domosdoshmëri pajisja e tyre me laboratorë, video, fjalorë të ndryshëm një- e dygjuhësh, si dhe të sigurohet letërsi e vendit, gjuha e të cilit mësohet, dmth. letërsi gjermane.

Të mësuarit dhe fillimisht, të siguruarit e letërsisë gjermane origjinale, është një kërkesë aktuale, bashkëkohore, e cila duhet të shoqërohet me mbledhjen e burimeve të tjera kulturore mbi gjuhën, historinë, gjeografinë etj.

Në literaturën pedagogjike e didaktike është shumë i njohur koncepti *“përsëritja, nëna e dijes”*. Nga ky koncept nuk shpëton as gjuha gjermane, për të cilën përsëritja, duke filluar nga ajo brenda orës mësimore, brenda kapitullit etj. është e domosdoshme, ashtu siç janë të domosdoshme ushtrimet për kujtesën, ruajtjen dhe zhvillimin e saj. Kjo lidhet me faktin se, dije të qëndrueshme kemi atëherë kur njohuritë e fituara, që mbahen mend për një kohë të gjatë, riprodhohen në mënyrë të vullnetshme.

Kjo është një kërkesë për brendinë e të mësuarit në përgjithësi, por për gjuhën e huaj, vetë specifikat e nxënies së saj, kujtesa ka rëndësi të veçantë dhe në këtë kuadër rëndësi të madhe merr edhe njohja e saj dhe mënyra e të ushtruarit për zhvillimin e mëtejshëm të kujtesës. Riprodhimi, përsëritja e lëndës duke sjellë variante apo informacione të pjesshme të reja, ose mjete mësimore që ndikojnë në konsolidimin e saj, si temë, kapitull, apo më gjerë, ndikojnë në sistemimin e njohurive, në thellimin e tyre, sidomos kur kjo shoqërohet me ushtrime dhe variante të tjera, deri tek loja gjuhësore apo mësimore. Nuk mund të ketë njohuri, shkathtësi e shprehi të thella e të qëndrueshme, pa ushtrimin e tyre, pa përsëritje.

Baza gjuhësore e nxënësve dhe e studentëve, ndonëse mund të jetë e afërt, nuk është e njëjtë. Pikërisht këto disnivele duhet t’i kapë syri i mprehtë i mësuesit dhe i pedagogut, i cili merr masa për mbulimin e mangësive në fusha të ndryshme të mësimin të gjuhës gjermane.

Kjo ka të bëjë me një parim themelor didaktik, *atë të trajtimit të diferencuar e individual të nxënësve dhe studentëve*, që do të thotë që nuk është çështje fakultative, që lihet në dëshirën e mësuesit dhe pedagogut, por është një problem parimor, i detyrueshëm për t’u zbatuar. Mënyra e zbatimit nga ana e mësuesit -ka fushën e krijimit e të origjinalitetit, në varësi të dëshirës së tij. Zhvillimi i mësimin kërkon shmangie nga verbalizimi i thatë, kërkon aplikimin e metodave audiovizuale- sidomos në përshpejtimin e të mësuarit të gjuhës së huaj.

Duhet te theksjome risinë në këto vitet e fundit -ku metodat audivizuale interaktive, janë futur dhe zbatohen gjerësisht në fakultetin tonë por edhe në disa gjimnaze, risi që duhet përgezuar – me shpresën e shtrijes edhe në institucionet e tjera arsimore. Kështu mësimi ndikon në formimin e koncepteve mbi bazën e perceptimit të drejtpërdrejtë të sendeve dhe dukurive të realitetit objektiv ose figurave të tyre.

Objektet më të cilat do të punohet nga nxënësit duhen parë, sepse janë sinjalet reale që kanë veti të ndryshme. Por edhe kjo nuk mjafton. Ato nuk perceptohen vetëm me anë të pamjes, por edhe duhen dëgjuar, prekur etj.

Zbatimi me aftësi *i parimit didaktik të konkretizimit*, që është aq i vjetër, i përcaktuar katër shekuj më parë nga pedagogu i nivelit botëror **Jan Amos Komenski** është njëkohësisht tërësisht i ri dhe

përherë aktual, edhe tani, në stadet e reja të modernizimit të procesit mësimor, pasi në mes të tjerave krijon emocione, lehtëson vëmendjen, ndihmon në të mbajturit mend të fjalëve, të shprehjeve frazeologjike, etj.

Duke zbatuar metoda audiovizuale dhe interaktive, arrihet të pajisen nxënësi apo studenti i gjermanishtes me strukturat kryesore të kësaj gjuhe, mbi bazën e një fjalori themelor. Kjo shoqërohet me një shmangie të përkthimit, të mësuarit përmendësh të rregullave gramatikore, duke nxitur përdorimin praktik të dukurive gjuhësore.

Përfundime

Në përgjithësi, në shkollat e larta mjetet audiovizuale dhe interaktive përdoren gjërësisht. Fushë përdorimi ato mund të gjejnë edhe në rastet kur duhet përshpejtuar mësimi i gjermanishtes. Kjo ndihmon në krijimin e shprehive gjuhësore bazë, në aftësimin për kuptimin e gjuhës në dëgjim, në kuptimin në shikim e dëgjim duke identifikuar përmbajtjen e çdo kuadri të paraqitur në film me dialogun, për të përvetësuar standartin e planifikuar të gjermanishtes.

Është e nevojshme njohja e mundësive për të përshkallëzuar e pasuruar më tej bazën mësimore didaktike dhe aftësimin e mësuesve dhe pedagogëve për shfrytëzimin e kësaj baze, që të mos mbetet si stoli në klasat-kabinet. Pa e fetishizuar rolin e madh të mjeteve mësimore didaktike, nënvijëzojmë rolin e madh që luajnë ato në përshpejtimin e ritmeve në mësimin e gjermanishtes, për krijimin e modeleve të qëndrueshme leksiko-gramatikore në kujtesën e nxënësit dhe nxitjen e mendimit të tij krijues për përvetësimin e gjuhës së huaj.

BIBLIOGRAFIA

- NEUNER, G / HUNFELD, H (1993): *Methoden des fremdsprachlichen Deutschunterrichts, eine Einführung*, Langenscheidt.
- DUDEN (1998), *die Grammatik*, Dudenverlag
- DIDAKTISCHES WÖRTERBUCH (2001), 3. Auflage, *Hand- und Lehrbücher der Pädagogik*, Oldenburg, Vjenë
- OSSNER, J / Zinsmeister (2014), H: *Sprachwissenschaft für das Lehramt*, Schönigh UBT, Paderborn